



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 04-610/01-3882/25  
Kaçanik, 27.02.2025

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 shkurt 2025, pos tjerash,


### **NJOFTOHET**

1. Me aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit, për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2024-2025, në bazë të dhënave të paraqitura në materialin e informatës të hartuar nga Drejtoria e Arsimit.
2. Në Informatë është paraqitur gjendja e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut, veprimet të cilat janë marrë nga Drejtoria e Arsimit dhe mekanizmat tjerë relevantë për përmbushjen e objektivave të planeve të punës sipas legjislacionit që e rregullon këtë fushë, përfshirë edhe vështirësitë që e kanë përcjellë në përmbushjen e objektivave.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejme, Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2024-2025 e përmbledhur në gjithsej: 18 faqe / Lënda: 04Nr. 610/01-3882/25.


Më këtë Shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Arsimit; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Drejtorja e Arsimit

04 Nr 610/01 - 3882/25

## I N F O R M A T Ë

Për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor 2024-2025

Kaçanik, Shkurt 2025

## Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor
3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve
  - 3.1 Transporti i nxënësve
4. Ngritja e cilësisë – zbatimi i Kurrikulës së re
5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimit parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)
  - 5.1. Rrjeti shkollor
  - 5.2. Sukseset e nxënësve – Arsimit fillor
6. Arsimit i Mesëm i Ulët (AMU, VI-IX)
  - 6.1. Numri i nxënësve dhe sukseset e tyre në dy nivelet 1 dhe 2
7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve
8. Edukimi dhe Arsimit i Mesëm i Lartë (AML X – XII)
  - 8.1. Numri i nxënësve
  - 8.2. Sukseset e nxënësve
9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

## Shkurtesat:

- DA Drejtoria e Arsimit
- MASHITI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- APF Arsimit Parafillor ose niveli 0
- AF Arsimit Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU Arsimit i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML Arsimit i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- AJF Arsimit Joformal
- ShML Shkolla e Mesme e Lartë

- IAAP Institucioni i Aftësimit dhe Arsimit Profesional
- ShFMU Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
- QEAP Qendra për Edukimin dhe Arsimin Parafillor

## 1. Hyrje

Informata për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të vitit shkollor ka për qëllim të informoj publikun e gjërë dhe institucionet komunale mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut gjatë Gjysmëvjetorit të Parë, për vitin shkollor 2024 - 2025. Informata përmban punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, respektivisht aktivitetet përgatitore për fillimin e vitit të ri shkollor, përgatitjet e objekteve shkollore, furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta, numrin e fëmijëve parafillor, fillor, të mesëm të ulët e mesëm të lartë dhe suksesin e arritur gjatë këtij gjysmëvjetori mësimor.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesi i arritur, kuadrin arsimor, mungesat e nxënësve e mësimdhënësve e të dhëna tjera të përgjithshme. Të dhënat e prezantuara janë bazë e mirë dhe mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, i cili zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 (Parafillor, Fillor, Mesëm të Ulët dhe Mesëm të Lartë).

Viti i ri shkollor 2024 - 2025 ka filluar me 2 shtator 2024 sipas kalendarit shkollor të hartuar nga MASHTI dhe ka përfunduar më 24 dhjetor 2024, Mësimi filloi në të gjitha institucionet arsimore: në 21 institucione shkollore të nivelit AF (Arsimi Fillor) dhe AMU (Arsimi i Mesëm i Ulët), prej tyre 16 shkolla të plota 1 - 9 dhe 4 të tjera ku mësimi zhvillohet për klasat 1-5 ndërkaq, në 1 shkollë mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-4, në 2 institucione të Mesme të Larta dhe në 1 çerdhe për fëmijë.

## 2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor

Edhe këtë vit shkollor kanë filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/25, në përputhje me nevojat e identifikuar dhe kërkesat për fillimin sa më të mbarë të procesit edukativo arsimor në Komunën tonë. Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e këtij fillim viti shkollor, sivjet janë regjistruar gjithsej 352 fëmijë para fillor, prej tyre 321 në shkollat filllore dhe 31 të tjerë në QEAP "Agimi" në Kaçanik, ndërkaq në këtë qendër parashkollore, nga moshë 9 muajshe

deri në 5 vjeç, janë të sistemuar gjithsej 121 fëmijë. Po ashtu, në bazë të të dhënave të shkollave filllore, sivjet në klasat e para janë regjistruar gjithsej 372 fatosë.

Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjinnnazin “Skënderbeu” dhe IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”.

Në Gjinnnazin “Skënderbeu”, në klasat e dhjeta janë regjistruar 140 nxënës, ndërsa ish-in planifikuar të regjistrohen 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore**, 4 paralele me 85 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shoqërore-Gjuhësore**, 3 paralele me 55 nxënës.

Ndërkaq, në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” janë regjistruar gjithsej 142 nxënës në 9 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 272 nxënës të ndarë në 3 Drejtimet:

Numri i nxënësve të regjistruar sipas drejtimeve dhe profileve në klasat e dhjeta:

**1. Elektroteknikë. Makineri prodhim dhe ndërtimtari me profilet:**

- Instalues Elektrikë, 1 paralele me 19 nxënës
- Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, 2 paralele me nga 15 nxënës (gjithsej 30 nxënës),
- Automekanik, 1 paralele me 14 nxënës
- Metalpunues, 1 paralele me 14 nxënës dhe
- Trafik rrugor, 1 paralele me 17 nxënës

**2. Ekonomi, administrim dhe juridik me profilet:**

- Nëpunës i kontabilitet dhe tatimeve, 1 paralele me 18 nxënës dhe
- Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës, 1 paralele me 15 nxënës

**3. Teknologji e informacionit dhe komunikimit me profilin:**

- Informatikë, 1 paralele me 16 nxënës.

Sa i përket kuadrit arsimor, DKA gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit për pozitat e lira: mësimdhënës të lëndës së matematikës në SHFMU “Gafurr Luma” në Gllloboçice (zëvendësim) dhe Gjimmnazin “Skënderbeu” (gjysmë norme), mësimdhënës të lëndës së Fizikës në SHFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër (zëvendësim) dhe IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik, mësimdhënës i lëndës Gjuhë Gjermane në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” me 10 orë (zëvendësim) dhe 2 (dy) edukatore në QEAP “Agimi” në Kaçanik. Në procedurë të rregullt është bërë vetëm përzgjedhja e mësimdhënësit të Gjuhë Gjermane në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik, ndërsa pozitave tjera janë plotësuar në ndërkohë.

### **3. Investimet në infrastrukturën shkollore e pajisje tjera dhe sigurimi i transportit të nxënësve**

Para fillimit të vitit të ri shkollor, në disa objekte shkollore janë bërë investimet kapitale në vlerë të përgjithshme mbi 500.000 euro prej të cilave 496,735 euro nga buxheti i komunës dhe pjesa tjetër nga granti i performancës apo donacione tjera. Në SHFMU “Gafurr Luma” në Gllloboçicë është ndërtuar fusha sportive për të cilin projekt ka investuar DKRS dhe është shpenzuar shuma prej 123,859 euro. Fusha sportive përfshinë fushën e futbollit, voleybollit, hendbollit dhe basketbollit dhe tribunat për shikues me 240 vende.

Në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec është ndërtuar palestra sportive (projekt dy vjeçar) për të cilin objekt janë investuar 313.000 euro, mjete nga buxheti i komunës. E njëjta është kompletuar me pajisje të nevojshme. Në SHFMU “Agim Bajrami” në Stagovë, është bërë riparimi i kulmit të aneksit të vjetër të shkollës për të cilin projekt janë shpenzuar 29,948 euro, ndërsa është bërë edhe gëlqerosja e hapësirës së brendshme e shkollës me punë vullnetare. Ndërkohë, në SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj është realizuar projekti për termoizolimimin dhe ndërrimin e dritareve për të cilin projekt janë shpenzuar gjithsej 77,777 euro, prej të cilave 62,104 euro janë nga granti i performancës dhe 15,673 euro nga buxheti i komunës.

Një projekt mjaft i rëndësishëm, ndërtimi i palestrës sportive ka filluar të realizohet edhe në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob, projekt dy vjeçar për të cilin do të shpenzohen 367.000 euro, nga buxheti i komunës. Në fazën e parë është investuar shuma prej 200 mijë euro ndërsa projekti do të finalizohet gjatë këtij viti shkollor. Në bashkëpunim me MASHTI-n ka filluar ndërtimi i çerdes për fëmijë në Rekë, ndërsa projekti i çerdes për fëmijë në Kaçanik të Vjetër do të financohet nga Bashkimi Evropian prandaj është prolonguar për vitin e ardhshëm për shkak të masave të vendosura për Kosovën, Për projektin “Ndërtimi i shkollës “Emin Duraku” në Kaçanik, janë kryer të gjitha procedurat që i takojnë komunës deri sa është lëshuar edhe Leja e ndërtimit, por mbetet në vullnetin e MASHTI-t për të vazhduar me procedurat e ndërtimit. Për pajisje të shkollave me tabela digjitale janë shpenzuar 8950 euro, për pajisje të shkollave me kompjuter janë shpenzuar 9344 euro, për vendosjen e roletave dhe

perdeve në shkollë, janë shpenzuar 28919 euro, për renovimin e hapsirave shkollë, janë shpenzuar 22000 euro dhe për furnizim të shkollave me pelet, janë shpenzuar 25669 euro. Edhe këtë vit shkollor, sikurse edhe dy vitet e kaluara, qeveria e vendit nuk ka bërë furnizimin e nxënësve me libra shkollë, ndërsa i ka subvencionuar me nga 80 euro nxënësit e nivelit 1 – 5 dhe me nga 110 euro nxënësit e klasave VI – IX, por jo edhe ata të nivelit parafillor. Furnizimi i nxënësve me libra edhe këtë vit ka qenë një nga sfidat më të mëdha të këtij fillim viti të ri shkollor. Vlen të theksohet se ka pasur shumë raste kur prindërit për shkaqe të ndryshme nuk kanë arritur të aplikojnë në sistemin eKosova, andaj edhe fëmijët e tyre kanë ngelur pa tekste shkollë por gjithashtu pas verifikimit të listave ka rezultuar se 312 emra të fëmijëve janë subvencionuar dhe nuk janë fare në shkollat tona.

### **3.1 Transporti i nxënësve**

Edhe këtë vit shkollor 2024-2025 sikurse edhe dy vitet e kaluara shkollë (2022 – 2023 dhe 2023 – 2024), Drejtoria e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimit dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Ferzi Guri dhe vëllezërit Çaka”. Mbi 14 mijë (14.470) euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, dhe nxënësve të lokaliteteve të fshatit Gilloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijnë në mesimet në Gjymnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të disa shkollave fillore të cilët udhëtojnë nga fshati Llanishte në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, nxënësit e fshatit Semajë, të cilët udhëtojnë në shkollën e Elezajve dhe atyre të Sllatinës të cilët udhëtojnë në shkollën e Doganajve. Ndërkaq, është 760 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas.

### **4. Ngritja e cilësisë - Zbatimi i Kurrikulës së re**

DKA, mbështet dhe përkrahë përkujdesjen për ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit tanë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë. Po ashtu, DKA vazhdimisht identifikon nevojat e mësimdhënësve për trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku synohet aplikimi i shkathësisë të reja, por edhe zhvillimit e ngritjes profesionale, ndërkaq zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë dhe ngritja e sistemit efikas ofron mundësi për sigurimin e cilësisë dhe përgatitjen e nxënësve për sfidat e jetës.

Me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, rritjes/shtimit të nivelit të përgjegjësive dhe angazhimit më të madh në shkollë, përgjatë një jave rresht (11 – 15 nëntor 2024), në SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë dhe dy Paralelet e ndara; në Vatë e Provoli është bërë vlerësimi i jashtëm i shkollës, respektivisht është realizuar Projekti “Përkrahja për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”, udhëhequr nga eksperti i fushës së

arsimit, z. Robert Bleasë, nga organizata KosEd, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian. Vlerësimi është bërë nga Ekipi Komunal për vlerësim i përbërë nga zyrtarë komunal të arsimit, drejtorë shkollash, koordinatorë të cilësisë, mësimdhënësit lëndor e klasor, ndërsa qëllim kishte përmirësimin e praktikave pedagogjike në klasë, përkatësisht identifikimin e praktikave jo të mira dhe dhënien e këshillave për përmirësimin e tyre. Vlerësimi është bërë edhe duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe performancës së shkollës, respektivisht 5 fushave të cilësisë: 1. Menaxhimi dhe qeverisja, 2. Zhvillimi profesional i mësimit dhe nxënies, 3. Mësimdhënia dhe nxënies, 4. Kultura dhe mjedisi dhe 5. Vlerësimi i performancës së mësimit dhe nxënies.

Vlerësimi i jashtëm i shkollës ka përfshirë edhe kriteret tjera: Organizimin dhe funksionimin e organeve të shkollës, Monitorimi i orëve mësimore dhe vlerësimi i performancës në arsim, Bashkëpunimi me klimën pozitive në shkollë, Bashkëpunimi me prindërit dhe përfshirja e tyre në organet vendimmarrëse etj.

Edhe gjatë këtij Gjysmëvjetori, Ekipi Komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevojë të veçanta ka identifikuar dhe vlerësuar 30 fëmijë me nevojë të veçanta, sipas kërkesave të prindërve. Për rastet e vlerësuar janë dhënë rekomandimet përkatëse si: sigurimi i asistencës, sigurimi i transportit etj. e për disa raste të tjera është rekomanduar qëndrimi i tyre në Qendrën Burimore në Prizren.

## **5. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimimi parafillor dhe fillor (0 dhe I-V)**

Duke u bazuar në plan-programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Kaçanikut, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim me shkollat dhe komunitetin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe nxënies.

Edhe gjatë këtij gjysmëvjetori, rëndësi e veçantë është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësisë, aftësisë për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe ndërtimit të personalitetit të tyre dhe mirëqenies së tyre në përgjithësi.

Arsimit parashkollor (nivelet 0) për fëmijët e moshës pesë vjeç, edhe deri më sot, është trajtuar në mënyrë meritore duke iu kushtuar vëmendje e veçantë. Në të gjitha shkollat fillore e të mesme të ulëta funksionojnë klasat parafillore, përveç në SHFMU "Dituria" në Ivajë dhe në paralelen e ndara fizike, në fshatin Strazhë dhe 2 paraleleve të ndara fizike në Vatë e Provolit të SHFMU "Kadri Zeka".

Në nivelin 0 (parafillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 352 fëmijë prej tyre 321 në shkollat fillore e të mesme të ulëta dhe 31 fëmijë të tjerë të përfshirë në QEAP "Agimi".



Arsimi bazë përfshinë nivelet 1 dhe 2 apo arsimin fillor (1-5) dhe arsimin e mesëm të ulët (6-9). Arsimi fillor e i mesëm i ulët ofron mundësi dhe synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arimit të mesëm të lartë.

Arsimi i mesëm i lartë (niveli 3), në Komunën e Kaçanikut zhvillohet në 2 shkollat e mesme të larta; në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe LAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka”. Përmes këtij niveli, synohet zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi, thellimi i dijeve në fusha të caktuara, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Drejtoria e Arsimit është e orientuar dhe angazhohet për përfshirjen apo krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, fokus është përfshirja e numrit sa më të madh të nxënësve në drejtimet që ofron Shkolla Profesionale “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” e po ashtu, edhe në Gjimnazin “Skënderbeu”.

### 5.1 Rrjeti shkollor

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 11 shkolla amë, fillore e të mesme të ulëta dhe 10 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Runjevë,
2. SHFMU “Idriz Seferi” në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre,
3. SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me paralelet e ndarë në Nikaj,
4. SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli,
5. SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj,
6. SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj me paralelet e ndarë në Bajnicë,
7. SHFMU “Qamil Ilazi” me paralelet e ndarë në Fushë të Pajtimit,
8. SHFMU “7 Shtatori” në Begracë,
9. SHFMU “Agim Bajrami në Stagovë,
10. SHFMU “Gafurr Luma” në Glloboçicë dhe
11. SHFMU “Dituria” në Ivajë me paralelet e ndarë në Strazhë.

Përveç shkollave fillore e të mesme të ulëta, në Komunën e Kaçanikut funksionojnë edhe 2 shkolla të mesme: Gjimnazi “Skënderbeu” dhe IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik dhe një qerdhe për fëmijë, QEAP “Agimi” në Kaçanik. Bazuar në gjendjen fizike të objekteve shkollore, mund të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF, AMU dhe AML është në nivel të kënaqshëm dhe ekzistojnë kushte relativisht të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor, me përjashtim të objekteve të vjetër të Shkollës

filllore “Emin Duraku” në Kaçanik dhe shkollës më Doganaj. Të dy këto objekte shkollore janë shumë të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndërkohë që nuk plotësojnë kushtet minimale për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Doganaj, i filluar në vitin 2019, sipas kontratës është dashtë të përfundoj më 2022 dhe tani më ka kaluar afatet kohore të planifikuara, ndërkohë DKA, është duke bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar investimet e nevojshme për ndërtimin e objektit të ri shkollor në shkollën e qytetit, përkatësisht objektit të SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik.

## **5.2 Sukses i nxënësve, Arsimi Fillor (1 – 5)**

Në nivelin fillor, nga gjithsej 2077 nxënës sa ishin të regjistruar në fillim të këtij Gjysmëvjetori, kanë vijuar gjithsej 2068 prej tyre, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 2047 nxënës, apo shprehur në përqindje 98.55 %. Me sukses negativ kanë ngelur 21 nxënës e 14 të tjerë nuk kanë vijuar ose janë çregjistruar.

Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkolror, gjithsej 2077 me 2228 sa ishin regjistruar një vit më parë (2023/24), atëherë del se në këtë vit shkolror, në këtë nivel, janë regjistruar gjithsej 151 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.14.

**Për më shumë të dhëna në nivelin I-V, shih Tabelën Nr. 1**  
**Suksesi në Arsimin Fillor (I - V) në Gjysmëvjetori i Parë të vitit shkollor 2024 -- 2025**

Klasa	SUKSESI POZITIV						SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						Nota mesatare												
	Gj.nxenes		Vijonë		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Miaft.		Gj.pozitiv		%		Me 1x1			Me 2x1		Me 3x1		Gj.negativ		Nuk vijojn		Te çregjis			
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		
I	370	180	365	179	255	139	58	22	40	17	14	1	365	179	98.65	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	1	4.48
II	437	212	435	212	234	124	105	50	74	34	14	1	427	209	97.71	2	1	3	1	3	1	8	3	1	0	1	0	1	0	4.01	
III	445	217	443	217	237	137	97	50	70	25	35	5	440	217	98.87	1	0	0	0	2	0	3	0	2	0	0	2	0	0	4.06	
IV	410	185	408	184	202	114	97	33	82	26	24	10	402	183	98.06	3	1	1	0	2	0	6	1	0	0	0	2	1	0	4.1	
V	420	211	417	209	199	129	100	48	86	30	31	4	413	208	98.33	0	0	0	0	4	1	4	1	4	1	2	2	1	0	4.09	
I-V	2077	1005	2068	1001	1127	643	457	203	352	132	118	21	2047	996	98.32	6	2	4	1	11	2	21	2	5	7	2	7	2	4.14		

**6. Arsimi i Mesëm i Ulët (VI-IX)**

Numri i nxënësve në AMU në fillim të vitit shkollor 2024-2025 ishte 1763, prej tyre 832 femra, ndërsa nëse e krahasojmë këtë numër me një vit më parë, (gjatë vitit shkollor 2023-2024, në këtë nivel shkollor kishte 1794), del se sivi jet, në nivelin e mesëm të ulët, janë gjithsej 31 nxënës më pak. Nga numri i përgjithshëm prej 1763 nxënësve të nivelit AMU, kanë vijuar 1743 (825 femra) dhe janë vlerësuar me nota pozitive gjithsej 1269 nxënës apo shprehur në përqindje 71.97 %, ndërkohë me nota negative kanë ngelur gjithsej 474 e 18 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del të jetë 3.81.

**Për më shumë të dhëna për nivelin VI-IX, shih Tabelën Nr. 2**  
**Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI - IX) në Gjysmëvjetorin e Parë të vitit shkollor 2024 – 2025**

Klasa	SUKSESI POZITIV						SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						Nota mesatare										
	Gj. nxenes		Vijojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Mjaft.		Gj. pozitiv		%		Me 1x1			Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijojnë		Te çregjis	
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F
VI	436	196	427	194	143	95	111	57	80	25	8	4	339	181	77.85	25	7	14	2	49	4	88	13	2	0	7	2	3.75	
VII	446	211	440	209	124	95	97	58	82	31	10	3	313	187	70.17	43	12	25	5	59	5	127	22	3	0	3	2	3.39	
VIII	427	208	425	208	136	99	74	49	83	37	20	5	313	190	73.06	30	7	17	4	65	7	112	18	2	0	0	0	3.04	
IX	456	217	451	214	131	94	96	67	67	19	10	2	304	179	66.66	46	17	18	2	83	16	147	35	4	2	1	1	3.38	
VI-IX	1763	832	1743	825	534	383	378	231	312	112	48	14	1269	737	71.42	147	45	77	14	276	34	474	93	11	4	11	7	3.81	

**6.1 Numri i nxënësve dhe suksesi i tyre në të dy nivelet 1 dhe 2 (I-V dhe VI –IX)**

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2024-2025 ka qenë 3847 (1837 femra) prej të cilëve kanë vijuar gjithsej 3811, ndërsa me sukses pozitiv janë vlerësuar 3316 apo 86.19 %. Ndërkaq, me nota negative kanë mbetur 495 nxënës prej tyre 98 femra e 36 të tjerë nuk kanë vijuar apo janë çregjistruar. Nota mesatare e përgjithshme e dy niveleve është 3.81.

Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2024-2025 (3847) me numrin e nxënësve të regjistruar një vit më parë që ishin 4022, atehëre del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 175 nxënës.

Për më shumë të dhëna për nivelin I-IX, shih Tabelën Nr. 3  
Suksesi sipas klasave I – IX në nivelin fillor dhe mesëm të ulët

Klasa	Gj. nxenes		Vijojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Mjaft.		Gj. pozitiv		%		Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj. negativ		Nuk vijojnë		Te cregjis		Nota mesatare		
	SUKSESI POZITIV		SUKSESI NEGATIV		TE PANOTUAR																										
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F			
I	370	180	365	179	255	139	58	22	40	17	14	1	365	179	98.65	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	1	4.48
II	437	212	435	212	234	124	105	50	74	34	14	1	427	209	97.71	2	1	3	1	3	1	8	3	1	0	1	0	1	0	4.01	
III	445	217	443	217	237	137	97	50	70	25	35	5	440	217	98.87	1	0	0	0	2	0	3	0	2	0	0	2	0	0	0	4.06
IV	410	185	408	184	202	114	97	33	82	26	24	10	402	183	98.06	3	1	1	0	2	0	6	1	0	6	1	0	0	2	1	4.1
V	420	211	417	209	199	129	100	48	86	30	31	4	413	208	98.33	0	0	0	0	4	1	4	1	2	2	1	2	1	0	0	4.09
I-V	2077	1005	2068	1001	1127	643	457	203	352	132	118	21	2047	996	98.32	6	2	4	1	11	2	21	5	7	2	7	2	7	2	4.14	
VI	436	196	427	194	143	95	111	57	80	25	8	4	339	181	77.85	25	7	14	2	49	4	88	13	2	0	7	2	3.75			
VII	446	211	440	209	124	95	97	58	82	31	10	3	313	187	70.17	43	12	25	5	59	5	127	22	3	0	3	2	3.39			
VIII	427	208	425	208	136	99	74	49	83	37	20	5	313	190	73.06	30	7	17	4	65	7	112	18	2	0	0	0	0	3.04		
IX	456	217	451	214	131	94	96	67	67	19	10	2	304	179	66.66	46	17	18	2	83	16	147	35	4	2	1	3	3.38			
VI-IX	1763	832	1743	825	534	383	378	231	312	112	48	14	1269	737	71.42	147	45	77	14	276	34	474	93	11	4	11	7	3.81			
I-IX	3847	1837	3811	1826	1661	1026	835	434	664	244	166	35	3316	1733	86.01	153	47	81	15	287	36	495	98	18	6	18	9	3.81			

Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

Nr.	shkoll.	Gjithësej nxënës						Vijojnë						SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV												Të Panotuar						Nota mesatare
		Gjithësej nxënës			Shkëq			Shumë mirë			Mirë			Mjaft.			Gjithësej pozitiv			%			1x1			2x1			3x1			Gj negativ			Nuk vijojnë			Cregjistruar						
		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F									
1	"ED"	1270	607	1267	607	349	294	152	187	66	40	5	1082	572	85	48	18	23	5	114	12	185	35	2	0	1	0	3.86																
2	"KZ"	360	171	347	165	83	72	46	64	24	19	3	290	156	80.55	14	5	9	1	34	4	57	9	2	0	11	6	3.86																
3	"S"	438	208	434	207	193	111	105	55	89	35	24	4	410	200	93.6	14	3	6	1	4	0	24	4	3	0	1	3.87																
4	"JG"	283	145	279	144	139	88	69	32	45	20	11	1	264	141	93	7	0	4	1	4	1	15	3	4	1	0	4.05																
5	"NO"	298	139	296	139	136	83	54	25	63	24	10	2	263	134	88	8	4	6	0	19	1	33	5	2	0	0	3.73																
6	"QI"	396	183	395	182	158	91	88	52	56	15	14	2	317	160	80	29	9	13	4	36	9	78	22	0	0	1	3.77																
7	"AA"	260	122	259	122	111	71	52	24	38	19	11	3	212	117	82	6	1	6	1	35	3	47	5	0	0	1	0	3.79															
8	"SH"	235	115	233	115	115	76	34	18	41	17	5	2	195	108	79	12	3	5	0	21	4	38	7	2	0	0	0	3.82															
9	"GL"	99	47	99	47	41	23	24	10	23	7	11	4	99	47	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.98															
10	"AB"	159	71	158	70	51	32	32	12	39	17	7	4	132	66	84	9	2	5	1	9	0	26	3	1	1	0	0	3.51															
11	"DKU"	49	26	45	26	19	16	7	5	13	4	9	5	45	26	91	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	3.7															
Gjith		3847	1837	3811	1826	1661	1026	835	434	664	244	166	35	3316	1733	86	153	47	81	15	287	36	495	98	18	6	18	8	3.81															

## **7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve**

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimi ndikon në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky tregues merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Në dy nivelet arsimore (I - V dhe VI- IX), në këtë Gjysmëvjetor janë angazhuar gjithsej 344 mësimdhënës (158 mashkuj e 186 femra) prej tyre 138 në mësimin klasor dhe 206 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë të gjithë (344) apo shprehur në përqindje 100 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU, përgjatë këtij gjysmëvjetori, kanë bërë gjithsej 48,625 mungesa prej tyre 38,510 të arsyeshme, ose 12.63 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë kësaj periudhe kanë humbur 1379 orë mësimore ose mesatarisht nga 4.0 orë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr. 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe mesme të ulëta

Nr.	Emri i shkolles	KUADRI ARSIMOR																Mesat për nx.	Orët e pambajtura të arsimt	Mesat për arsimt
		Mësimi i ndëror				Dy ciklet				Mungesat e nxënësve										
		Mësimi i klasor		Mësimi i ndëror		Dy ciklet		Mungesat e nxënësve		Mungesat e nxënësve		Mungesat e nxënësve								
Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	Gj	ARS.	Gj	ARS.					
1	"Emin Duraku"	35	34	35	100	44	24	44	100	79	58	79	100	19308	14517	15.2	190	2.41		
2	"Kadri Zeka"	16	6	16	100	20	10	20	100	36	16	36	100	5317	3803	14.76	91	2.52		
3	"Idriz Seferi"	19	13	19	100	22	11	22	100	41	24	41	100	4683	4126	10.69	157	3.82		
4	"Jusuf Gërvalla"	12	9	12	100	17	8	17	100	29	17	29	100	3842	3685	13.57	193	6.65		
5	"Qamil Ilazi"	15	10	15	100	16	7	16	50	31	17	31	100	4157	3624	10.49	242	7.8		
6	"Nazmi Osmani"	10	9	10	100	16	7	16	100	26	16	26	100	3106	2878	10.42	68	2.61		
7	"Ali Asllani"	8	5	8	100	18	7	18	100	26	12	26	100	3405	2532	13.14	75	2.9		
8	"7 Shtatori"	7	3	7	100	14	8	14	100	21	11	21	100	2749	1723	11.74	31	1.47		
9	"G.Luma"	6	2	6	100	10	2	10	100	16	4	16	100	801	614	14.29	43	2.68		
10	"A.B."	5	3	5	100	12	3	12	100	17	6	17	100	1050	884	6.6	236	13.1		
11	"Dituria"	5	0	5	100	17	5	17	100	22	5	22	100	207	124	4.22	53	2.4		
	Gjithsej	138	94	138	100	206	92	206	100	344	186	344	100	48625	38510	12.63	1379	4		



## 8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (X – XII)

Në arsimin e mesëm të lartë, synim kryesor është zhvillimi, zgjerimi dhe thellimi i dijes e njëkohësisht edhe kultivimi i identitetit personal, zhvillimi i përgjegjësi, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që nxënësit të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integritimit më të lehtë të tyre në shoqëri.

Edukimit dhe arsimimit në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë (AML), po ashtu, i është kushtuar rëndësi e veçantë pasi në këtë nivel merren hapat për të vazhduar studimet superiore, e po ashtu, edhe për përgatitjen profesionale të gjeneratave për tregun e punës.

### 8.1 Numri i nxënësve

Në vitin shkollor 2024-2025 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 895 nxënës (503 mashkuj dhe 392 femra) prej tyre 482 në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 413 në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të regjistruar këtë vit shkollor prej 895 nxënës, me atë të vitit të kaluar prej 965 nxënës, atëherë del se sivjet në të dy shkollat e mesme janë regjistruar 70 nxënës më pak.

Në kuadër të Gjimnazit “Skënderbeu” janë duke funksionuar 2 drejtime me po aq profile: Shkenca Natyrore me gjithsej 12 paralele (nga 4 paralele në klasat X, XI dhe XII) dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, po ashtu me 10 paralele dhe ate 3 në klasën e X, 3 në të XI dhe 4 paralele në të XII.

Ndërkaq, në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” procesi mësimor është duke u zhvilluar në 29 paralele dhe atë 9 paralele në klasat e dhjeta me 5 drejtime: 1 Instalues elektrik me 1 paralele, 2. Instalues i ngröjhjes, klimatizimit dhe ujësjellësit, me 2 paralele 3. Automekanik, me 1 paralele, 4. Metalpunues, me 1 paralele dhe Trafik rrugor, me 1 paralele. Në klasat e njëmbëdhjeta 10 paralele me 4 Drejtime: 1. Elektronikë, 3 paralele, 2. Makineri me 4 paralele, 3. Ekonomi, 2 paralele dhe 4. Juridik, 1 paralele e po ashtu, 10 paralele në klasat e dymbëdhjeta me 3 Drejtimet: 1.Elektronikë, me 2 paralele, 2.Ekonomi, me 3 paralele dhe Makineri me 5 paralele.

### 8.2 Sukseset e nxënësve

Nga numri i përgjithshëm prej 895 nxënës (392 femra) të regjistruar në fillim të vitit, mësimin e kanë vijuar gjithsej 864 nxënës, prej tyre 384 femra, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 504 ose 56.31 %.

Me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 360 nxënës ose 40.22 % prej tyre dhe të panotuar e të çregjistruar kanë mbetur gjithsej 31 të tjerë. Sukseset e arritura reflekton vlerësimin e njohurive të arritura të nxënësve për këtë Gjysmëvjetor të vitit shkollor 2024-2025, ndërkaq nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.1 dhe atë në Gjimnazin “Skënderbeu” 3.66 dhe IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” 2.52.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.6

Suksesi në shkollat e Mesme të Larta në Periudhën e Parë të vitit shkollor 2024-2025

Emri i shkollës	Klasa	Ta regjistruar		Vijone		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV				TE PA NOTUAR				në nota mesatare					
		Gj	F	Gj	F	Sh.këllq.	Sh.mirë		Mirë	Mjaft		Gjith pozitiv	%	1X1		1X2		Përsërisin me 3x1		Gjithsej		Nuk vijojt			Të përgjatur				
							GJ	F		GJ	F			GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ
		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		Gj	F	Gj	F	Gj
"Skenderbeu"	X	140	87	138	85	41	28	46	27	15	0	0	114	70	82.6	17	10	3	2	4	3	24	15	2	2	0	0	3.88	
	XI	169	113	166	111	41	35	49	35	24	13	0	114	83	68.7	30	18	9	2	13	8	52	28	3	2	0	0	3.69	
	XII	173	107	170	106	37	33	39	33	30	20	4	110	88	64.7	25	8	12	3	23	7	60	18	3	1	0	0	3.41	
"F. G. dhe v. Ç."	Gj	482	307	474	302	119	96	134	95	81	48	4	338	241	71.3	72	36	24	7	40	18	136	61	8	5	0	0	3.66	
	X	142	31	133	30	2	1	10	0	38	12	8	5	58	18	40.84	24	2	10	1	41	9	75	12	9	1	0	0	2.47
	XI	127	24	120	23	3	1	11	1	29	9	10	2	53	13	41.73	26	4	14	1	27	5	67	10	7	1	0	0	2.56
IAAP "F. G. dhe v. Ç."	XII	144	30	137	29	7	3	5	2	34	11	9	3	55	19	38.19	42	5	19	5	21	82	10	7	1	0	0	2.55	
	Gj	413	85	390	82	12	5	26	3	101	32	27	10	166	50	40.2	92	11	43	7	89	14	224	32	23	3	0	0	2.52
	Gjithsej	895	392	864	384	331	101	160	98	182	80	31	12	504	291	56.3	164	47	67	14	129	32	360	93	31	8	0	0	3.1

9. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në AML

Nxënësit e këtij niveli, në fund të kësaj periudhe, kanë bërë gjithsej 26495 mungesa (11,593 mungesa nxënësit e Gjinnazit dhe 14,902 ata të IAAP) prej të cilave me arsye 17.645 ose 29.60 për kokë nxënësi. Numri i orëve të humbura nga nxënësit është relativisht i lartë, ndërkohë që DA kërkon nga shkollat përkatëse të ndërmarin masa adekuate me qëllim të zvogëlimit në minimum numrin e orëve të humbura mësimore.

Ndërkaq, mësimdhënësit e këtij niveli të AML-së kanë humbur gjithsej 585 orë mësimi apo 6.29 orë mësimi për një mësimdhënëës. Ngrija profesionale e mësimdhënëseve është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor për mësimdhënie e nxënie të suksesshme. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 83 mësimdhënëës, të gjithë të kualifikuar (100%), prej tyre 38 në Gjinnazin “Skënderbeu” dhe 45 në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

**Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7**

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënëseve në shkollat e Mesme të Larta

Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR				Mungesat e nx		Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%	Gj	Arsyeshme			
1	Skënderbeu	38	20	38	100	11593	8388	24.05	217	5.71
2	IAAP	45	16	45	100	14902	9257	22.65	368	8.17
	<b>Gjithsej</b>	<b>83</b>	<b>36</b>	<b>83</b>	<b>100</b>	<b>26495</b>	<b>17645</b>	<b>23.35</b>	<b>585</b>	<b>6.29</b>

DKA mbetet e përkushtuar dhe angazhohet për rezultate dhe suksese edhe më të mira duke promovuar një sistem arsimor më të avancat e bshkëkohor të krahasueshëm me ato të vendeve më të zhvilluara.

Drejtori i Drejtorisë  
Zaim Doda  
